

**EDMOND MALAJ**

**MARRËDHËNIET EKONOMIKE DHE TREGTARE  
NDËRMJET RAGUZËS DHE TROJEVE ARBËRORE**

**Abstrakt:**

*Në artikull trajtohet tregtia ndërmjet Republikës së Raguzës dhe trojeve arbërore gjatë Mesjetës. Artikulli paraqet një sërë çështjesh në lidhje me këtë tematikë. Pjesa e parë është konceptuar si hyrje. Në pjesën e dytë jepen të dhëna në lidhje me rrugët tregtare, kurse pjesa e tretë merr në shqyrtim marrëdhëniet tregtare dhe marrëveshjet e ndryshme ndërmjet Raguzës dhe sunduesve arbërorë. Pjesa qendrore e artikullit hedh dritë jo vetëm mbi llojet e mallrave që shkëmbeheshin nëpërmjet këtyre dy vendeve, por edhe qytetet dhe tregjet lokale, të cilat merreshin me prodhimin e mallrave dhe shërbimin për tregtimin e tyre. Artikulli bazohet qoftë në punime të autorëve të ndryshëm, qoftë në dokumente arkivore, të cilat zënë këtu një vend parësor.*

**Fjalë kyçe:**

Raguza, Arbëria, tregjet, mallra, tregtia e kripës, e drithit, e mishit, e vajit, e verës, e drurit, lëkurëve dhe e dyllit.

**Dy fjalë hyrëse**

Në mesjetë hapësira arbërore ishte me rëndësi për Republikën e Raguzës edhe në lidhje me ekonominë e tregtinë. Patricët dhe tregtarët raguzanë kishin marrëdhënie intensive me hapësirën arbërore. Së pari, mund të përmendet këtu tregtia e kripës, që për raguzanët kishte rëndësi të veçantë ekonomike;<sup>1</sup> së dyti, krahinat shqiptare ishin furnizues të Raguzës me mish, drithë, vaj ulliri (nga Tivari) dhe këtu nuk bëhet fjalë vetëm për import në Raguzë por edhe për import të mëtejshëm për në

---

<sup>1</sup> Konstantin Jireček, *Die Bedeutung von Ragusa in der Handelsgeschichte des Mittelalters*, Vortrag gehalten in der feierlichen Sitzung der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften am 31. Mai 1899, Wien: Hof und Staatsdruckerei 1899, f. 24-25.

Venedik;<sup>2</sup> dhe së treti, përmes krahinave shqiptare kalonin disa rrugë kryesore tregtie që ishin të lidhura me rrugë të tjera brenda vendit.

Produkte që dilnin nga trojet arbërore ishin veçanërisht druri i lisit, ato të pyllit, fruta dhe kokone të grethit (*Cynips quercusfolii*) të lisit valonean (*cuercus vallonea*), pema ngjyrosëse të sumakut (*Rhus coriaria*)\*, por në mënyrë të veçantë prodhime të blegtorisë, bagëti, mish, lëkura dhe gëzofë.<sup>3</sup> Këtyre u shtoheshin edhe peshqit, veçanërisht ngjالات, saragat apo gjuhcat (*scoranze*) nga liqeni i Shkodrës si dhe putargat e kripura (ital. *bottarga*). Nga Vlora eksportoheshin fajkoj për gjueti.<sup>4</sup> Pra, kemi një gamë të gjerë produktesh që shkëmbeheshin ndërmjet trojeve arbërore dhe Republikës së Raguzës.

Përsa i përket tregtarëve, në këtë artikull, do të mundohemi që të paraqesim qoftë raste tregtarësh shqiptarë që vepronin në Raguzë, qoftë tregtarë raguzanë që ishin të pranishëm në qytetet, portet dhe në tregjet e Arbërisë mesjetare. Shqiptarët arritën të kishin sukses ekonomik dhe bile në vitin 1386, ulqinakët bënë në Raguzë stampa të monedhave.<sup>5</sup> Tregtarët arbër bënë pjesë edhe në vëllazëri të ndryshme, të cilat në shek. XV njihen edhe si “*mercatores*” dhe *Antunini* dhe në shumë raste ishin madje të lidhur me njëri-tjetrin edhe në formë martesash dhe krushqish. Këto bënë pjesë në të ashtuquajturën shtresë *de populo*, të cilët ishin tregtarë

<sup>2</sup> Irmgard Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern während des Mittelalters. Randbemerkungen zur Problematik der balkanologischen Forschung”, në *Beiträge zur Südosteuropa-Forschung*, Anlässlich des I. Internationalen Balkanologenkongresses in Sofia 26.VIII-1.IX.1966, botuar nga Arbeitskreis Südosteuropa-Forschung bei der Deutschen Forschungsgemeinschaft, München: Trofenik, 1966, f. 346.

\* *Shënim i autorit*: Pema ngjyrosëse e sumakut (*Rhus coriaria*), (gjerm. *Gerbersumach*), është bimë mesdhetare që kishte përdorim të ndryshëm. Frutat përdorshin për erëza; gjethet përdorshin për regjje lëkurësh, kurse rrënjët përdorshin për ngjyrosje leshi.

<sup>3</sup> Konstantin Jireček, “Die Lage und die Vergangenheit der Stadt Durrazzo im Mittelalter”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 153.

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Milan von Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*, Vorgelegt in der Sitzung am 24. April 1918. Wien/Leipzig: Hölder-Pichler-Temsky, 1924, f. 67-68.

të pasur.<sup>6</sup>

Përveç shqiptarëve, ndër komunitetet që përmenden për marrëdhëniet tregtare janë dhe hebrenjtë e Durrësit. Ata bënë tregti me Italinë, Serbinë dhe me Raguzën<sup>7</sup> duke eksportuar kripë dhe importuar tekstile të ndryshme.<sup>8</sup> Përsa i përket këtij komuniteti gjatë hulumtimeve gjetëm edhe dy dokumente që bëjnë fjalë për një drejtues të komunitetit të judejve (*magister Yudayce*) me emrin David nga qyteti i Durrësit, për punët e tij tregtare dhe për skribën komunal të judejve.<sup>9</sup> Emri i David Judeut nga Durrësi na shfaqet në dokumentet e datave 15 gusht dhe 25 gusht të vitit 1368.

Në dokumentin e parë të datës 15 gusht thuhet se “*Davidi, magjistri judaik i Durrësit, sipas dëshmisë së Mojsiut të birit të noterit Mateo dhe Mojsiut të birit të Salomonit, jude nga Durrësi, pranonte në mbikëqyrjen e Palit mallrat e besuara për Fran Franceschino Giorgio de Venetiset të përfaqësuar nga Andriolo Contareno*”<sup>10</sup> kurse në dokumentin tjetër të lëshuar po në Raguzë më 25 gusht 1368, “magjistri Davit Judeu, banues i Durrësit, pranonte në emrin e tij dhe garantonte me të gjitha pronat e tij që për të gjithë muajin nëntor të ardhshëm detyrohej ti japë Boktase de Bronates në Vlorë në anijen e quajtur Bohtasse, ngarkesë me kripë sipas masës së Vlorës, në këmbim të 95 (VC)\* dukateve të arit që kishte marrë prej tij, dhe se zotohej se do të paguante një gjobë prej 98 dukatësh

<sup>6</sup> I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...”, f. 370.

<sup>7</sup> Josip Luetić, “Die Republik von Ragusa als Seemacht mit besonderer Berücksichtigung der italienisch-albanischen Handelsbeziehungen”, në *Münchener Zeitschrift fuer Balkankunde* 9. Veröffentlicht von Peter Bartl [u.a]. München: Slavica 1993, f. 20.

<sup>8</sup> Simon Marcus, “Durazzo”, në *Encyclopaedia Judaica*, Ed. Michael Berenbaum and Fred Skolnik, Vol. 6, 2nd ed. Detroit: Macmillan Reference USA, 2007, f. 38-39.

<sup>9</sup> Po aty, f. 62.

<sup>10</sup> *Državni Arhiv u Dubrovniku* (më tej: DAD), Div. Canc. 1366-1368: “1368, 15. augusti. Ragusii. David magister Judaico de Durachio” *secundum testimonium “Moyses filii notarii Mathei et Moyses filii Salomonis, Judeorum de Durachio” accepta Paulo spiciario depositum pro Franceschino Georgio de Venetiset pro Andriolo Contareno*”, në: *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*, Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay, Volumen II (Annos 1344-1406 conteniens Vindobonae MXXVIII, Typis Adophi Holzhausen, dok. nr. 248. (cituar më tej: AAlb. II)

\* Forma VC që është numri 95 është një shifër jo e rregullt, i cili përdorej në vend të shifrës së saktë XCV (95) në Mesjetë.

(IIC)\*\* , nëse nuk do ta sillte në kohën e duhur dhe sipas marrëveshjes, ngarkesën e sipërpërmendur”.<sup>11</sup> Aktivitetet më të shumta detare i bënin shqiptarët nga qytetet e Durrësit, Vlorës dhe të Lezhës, respektivisht nga qytetet ku ishin edhe portet e mëdha shqiptare.<sup>12</sup> Tregtarët shqiptarë ishin nga Shkodra, Lezha, Elbasani, Durrësi, por edhe nga Prishtina.<sup>13</sup> Kalorësi Georgius Passimada nga Durrësi dha hua dy veshje festive në vitin 1373 në Raguzë.<sup>14</sup>

Në gjysmën e dytë të shek.XIV përmenden edhe të bijtë e Boksa Gurgdhendësit.<sup>15</sup> Ata u bënë tregtarë të pasur nëpërmjet tregtisë me Bosnjën. Gjergji (*Georgius*), bashkë me djalin e tij Nikollën (*Nicola*) u bënë protovestiarë të Mbretit të Bosnjës. Gjergji qe protovestiar gjatë

\*\* Forma IIC që është numri 98 është një shifër jo e rregullt, i cili përdorej në vend të shifrës së saktë XCVIII (98) në Mesjetë.

<sup>11</sup> DAD, Deb. Notariae 1362-1370, fol. 155: “1368, 25. augusti. Ragusii. Ego quidem magister Dauit Judeus habitator Duracii confiteor, quod super me et super omnia bona mea usque per totum mensem novembrem proxime futurum me obligo dare Bochdasse de Bronata in Valona in nauigium dicti Bohdasse (!) miliaria quinque salis franchi et hoc ad mensuram Valone pro ducatis auri V<sup>c</sup>, quos habui et recepi ab ipso inter denarios et pannos qui denarii et panni ire debent de Ragusio usque Duracium ad risigum et fortunam dicti Bochdasse. Et si ego non darem dictam quantitatem salis at terminum superscriptum eidem Bochdasse uel eius nuntio mittendo nauigia ad accipiendum dictum salem, cadam ad penam ducatorum II<sup>c</sup> eidem Bochdasse pro suo dampno et interesse. Et nos Muscus Mathey Judeus et Muscus eius frater se constituimus pleçii et pagatores eidem Bochdasse pro dicto magistro Dauith, si ipse non daret dictam quantitatem salis at dictum terminum et ad omnia superscripta. Et si Laçerus, cugnatus dicti magistri Dauit moriretur ante terminum vel extraheret (!) de officio eius, quod teneamur solummodo ad restitutionem pannorum vel ducatorum V<sup>c</sup>, tenendo se ad nos tres uel ad vnum de nobis, qualiter primum voluerit in parte et in totem, prout dicto Bochdasse placuerit se tenere. Renunpantes etc. Ser Lucas de Bona iudex et Çiue de Martulino testis”, në: AAlb. II, dok. nr. 248.

<sup>12</sup> J. Luetić, “Die Republik von Ragusa ...”, f. 19.

<sup>13</sup> Po aty, f. 20.

<sup>14</sup> “dous robas unam de scarlato et aliam de merscla bruna fulcitas perils et friiriis pro ducatis L”. AAlb. II, dok. nr. 310; shih edhe: M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens...*, f. 46.

<sup>15</sup> Riccardo Belcari, “Da Antivari a Ragusa. Litotecnica dell’Edilizia medievale in Dalmazia”, në *VII Congresso nazionale di archeologia medievale* (Palazzo Turrisi, Lecce, 9-12 settembre 2015, Volume 1, a cura di Paul Arthur, Marco Leo Imperiale, Firenze: All’Insegna del Giglio, 2015, f. 129.

viteve 1369-1388, kurse i biri i tij Nikolla gjatë viteve 1404-1405.<sup>16</sup> Gjergji përmendet si “*egregious miles*” dhe kishte arritur të ketë prona të paluajtshme edhe në Bosnjë ndërsa shtëpia e tij në Raguzë ishte njëra nga shtëpitë më të bukura e më madhështore në qytet.<sup>17</sup> Mbesave të tij që ishin të martuara në dyer fisnike të Kotorrit, dhe dy bijave të tij ai u kishte dhënë një prikë prej 4000 perperësh, dhe në testamentin e tij i la së shoqes një shumë prej 10.000 dukatesh.<sup>18</sup> E shoqja u bë më vonë edhe administratorja e pasurisë së tij.<sup>19</sup>

Në pamundësi që të trajtojmë shumë çështje brenda kufijve të këtij artikulli, do të përqendrohemi kryesisht në praninë e tregtarëve raguzanë, aktivitetin e tyre në Arbëri, duke paraqitur qoftë lokalitetet ku ata e ushtronin atë, llojet e ndryshme të tregtisë etj. Por, kjo nuk do të thotë që herë pas here të japim edhe ndonjë të dhënë rreth aktivitetit të tregtarëve shqiptarë në Raguzë. Tani më poshtë, para se të japim të dhëna për tregtinë e mallrave të ndryshme, po i hedhim një vështrim rrugëve dhe qendrave tregtare ku vepronin tregtarët raguzanë dhe agjentët e tyre.

## Rrugët tregtare

Transportimet e mallrave dhe e gjithë kjo tregti realizohej nëpërmjet rrugëve ujore dhe tokësore. Së pari, ia vlen që të hidhet një vështrim i detajuar në lidhje me rrugët që përdorshin për tregti.

Një rrugë e rëndësishme ishte e ashtuquajtura Rruga e Zetës në Veri, e cila kalonte nëpër Tivar dhe Ulqin, afër derdhjes së Bunës, pastaj nëpër Shën Shirq të shpinte në Shkodër, ku kishte një komitet tregtarësh raguzanë që kishin krijuar një lagje të tyren në afërsi të kishës së Shën Vlashit, poshtë kalasë dhe në afërsi të portit, në zonën e ashtuquajtur “Nënshkodër” (*Sub-Scutari*)<sup>20</sup>. Kjo rrugë kishte një rëndësi të madhe,

<sup>16</sup> “*Filius huius Bogšae Georgius postea (1369—1388) protovestiarius erat regis Bosnae, similiter etiam eius filius Nicola (1402-1407, cf. M. Ragusinae 4, 156); Jireček I. c.*”, *AAlb*. II, dok. nr. 34.

<sup>17</sup> I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...”, f. 372-373.

<sup>18</sup> Po aty, f. 373.

<sup>19</sup> Đuro Tošić (Ђуро Тошић), “Никола Бокшић (На странпутици пословне каријере)”, në *Историјску Часопис*, Књ. LIX, Београд: 2010, f. 174.

<sup>20</sup> (*extra Scutari ad Sanctum Blasium 1433, S. Blasius prope civitatem Scutari 1444*). Konstantin Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar

sepse lidhte me anë të tokës Raguzën me Shkodrën. Karvanët niseshin nga Shkodra për të shkuar në Raguzë, ndiqnin ose rrugën nëpër Ulqin ose atë nëpër Tivar, më tej vazhdohej në drejtim të Kotorrit.<sup>21</sup> Kjo rrugë e vjetër njihet edhe me emrin Rruga e Zetës, sepse kalonte nëpër të ashtuquajturat Zetë e Epërme dhe Zetë e Poshtme. Në këtë rrugë, porti i Shirqit mbi lumin Buna kishte një rëndësi shumë të madhe.

Një rrugë tjetër ishte edhe e ashtuquajtura *Rruga e Madhe*, e cila fillonte në Shkodër, përshkonte trojet e bregut lindor të liqenit të Shkodrës, kalonte nëpër Nikshiq dhe futej në luginën e Neretvës (Narenta).<sup>22</sup>

Nëpër Shkodër kalonte një rrugë tjetër që të çonte në Dejë dhe në Vaun e Dejës, pastaj në Prizren dhe aty degëzohej, njëra degë të çonte më tej nëpër Kosovë<sup>23</sup> dhe vazhdonte pastaj për në krahinat serbe, ku kishte miniera dhe në Sofje, ndërsa dega tjetër të çonte për në Shkup dhe nga aty për në Selanik.<sup>24</sup> Një përshkrim të detajuar të kësaj rruge dhe të degëzimeve të saj e paraqet Jireček në veprën e tij “*Rrugët tregtare dhe minierat e Serbisë dhe të Bosnjës gjatë Mesjetës*”, ku sipas tij nga Shkodra deri në Prizren udhëtimi zgjaste rreth 33 orë ecje dhe vazhdonte duke kaluar nëpër Pult dhe trojet e Dukagjinëve që ishin në të majtë, kurse në të djathtë ndodheshin territoret e mirditasve.<sup>25</sup>

Stacioni i parë kryesor në këtë rrugë ishte *Puka* (e quajtur *Epicaria* nga Ptolemeu, dhe në hartën Peutingerine emërtohet *Picaria*), më tej kalohej nëpër një zonë me pyje të vjetër e të dendur, nëpër Qafën e Malit, mbërrihej te *Hani i Sakatit* (Sakato 1348) në *Pultin e Sipërm* dhe si stacion tjetër ishte *Spasi*, i cili në mesjetë ishte një qendër e madhe

---

Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte, München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 108.

<sup>21</sup> Alvin Saraçi, *Tregtia Adriatike e Shkodrës me Republikën e Venecies në shekujt XVII dhe XVIII*, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2018, f. 15.

<sup>22</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter...”, f. 97.

<sup>23</sup> Gjon Berisha, “Marrëdhëniet e Gjergjit II Strazimir Balshës me Republikën e Raguzës”, në *Studime historike*, nr. 3-4/2019, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2020, f. 47.

<sup>24</sup> I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...”, f. 373.

<sup>25</sup> Constantin Jireček, *Die Handelsstrassen und Bergwerke von Serbien und Bosnien während des Mittelalters*. Historisch-geographische Studien, Von Dr. Constantin Jos. Jireček. Prag: Verlag der Böhmischen Gesellschaft der Wissenschaften 1879, f. 66.

doganore (*Carina u Sv. Spasa*).<sup>26</sup> Aty në afërsi, në grykëderdhjen e përroit Gruma (Krupa 1348) në Drin, në të djathtë të bregut të këtij lumi, mbi një shkëmb shiheshin akoma rrënojat e Kalasë së Lekë (*Alex*) Dukagjinit. Rruga këtu ndahej në dy degë. Njëra degë duke kaluar nëpër luginën e përroit *Gruma* (Krupa) të çonte deri në *Gjakovë* e më tej në *Pejë*,<sup>27</sup> ku vepronte një konsull raguzan.<sup>28</sup>

Dega tjetër, ajo më kryesorja vazhdonte nëpër bregun e majtë të Drinit duke kaluar nëpër fshatra të vjetra (*Srixhe, Shiklja* dhe *Kryemadh*), të cilat dikur Stefan Dushani ia pat dhuruar manastirit të Kryeengjëjve në Prizren. Tek një vend i quajtur Hani i Vezirit kalohej Drini mbi një urë të gjatë osmane, por që këmbët e saj duket se ishin shumë më të vjetra se vetë ura osmane.<sup>29</sup> Pastaj rrugës vihej re edhe vendtakimi i Drinit të Bardhë me Drinin e Zi dhe më tej kalohej mbi një urë të vjetër mbi lumin *Luma*, i cili ishte një lum dytësor i Drinit të Bardhë. Pas urës arrihej Fusha e Prizrenit, qytet i cili shtrihej në këmbën veriore në Malësisë së Sharrit.<sup>30</sup>

Qyteti i *Prizrenit* përshkruhet nga Jireçeku si qytet i madh, qoftë në Mesjetë qoftë edhe në kohën e autorit (shek. XIX), ngaqë aty kryqëzohen rrugë të rëndësishme që vinin nga Adriatiku e kalonin nëpër Fushë-Kosovë e në Maqedoni. Aty kishte një treg<sup>31</sup> dhe një doganë.<sup>32</sup> Prizreni ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe në lidhjet tregtare me Raguzën. Në Prizren kishte një konsull raguzan të rregullt me një rrogë vjetore të caktuar që në vitin 1325, që duhet të qëndronte aty për një vit dhe duhet të paraqiste interesat e republikës tek oborri i mbretit serb.<sup>33</sup> Që nga viti 1332, ky konsull ishte në Prizren tashmë një seli fikse, nga ku mund të kontrollonte dy herë në vit lokalitetet serbe në të cilat ishin krijuar koloni tregtare raguzane dhe i duhej të përfaqësonte dhe të paraqiste interesat e këtyre kolonive tek mbreti serb.<sup>34</sup> Përveç konsullit kishte edhe të

<sup>26</sup> Po aty, f. 67.

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> Muhamet Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shekujve XII-XVII*, me vështrim të posaçëm në marrëdhëniet kroate-hungareze dhe austriake, Unioni i Bashkësive Shqiptare në Republikën e Kroacisë, Zagreb: 2010, f. 125.

<sup>29</sup> C. Jireček, *Die Handelsstrassen und Bergwerke...*, f. 67.

<sup>30</sup> Po aty.

<sup>31</sup> *AAlb.* II, dok. nr. 33, 108.

<sup>32</sup> *Po aty*, dok. nr. 58, 108, 322.

<sup>33</sup> I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 352.

<sup>34</sup> Po aty.

ashtuquajturit *conductores mercatorum* “kontraktorët e tregtarëve”. Në vitin 1348 në Prizren dhe Novobërdë përmenden vëllezërit raguzanë Marcus dhe Matheus De Basileo.<sup>35</sup>

Një qytet tjetër i rëndësishëm i Kosovës ishte edhe Peja ku të çonte dega tjetër që përmendëm më sipër. Në shek. XIV aty kishte një koloni raguzane dhe një trafik të madh mallrash.<sup>36</sup> Nga Peja rruga të çonte për në Bërskovë (*Brescoua*) (sot Mojkovac të Malit të Zi), jo shumë larg krahinës së Plavës. Bërskovë ishte një qytet i rëndësishëm tregtie për Serbinë, sepse prej aty rruga shkonte për në Kotorr dhe më tej për në Dubrovnik. Bërskova kishte monedhën e vet të njohur si Groshët e Bërskovës (*Grossi di Brescoua*) dhe ishte një vend grumbullimi mallrash të ndryshme, një doganë që administrohej nga raguzanët, me një koloni dhe konsull raguzan që përmendet rreth vitit 1280.<sup>37</sup> Pikërisht në Bërskovë është dokumentuar një ndodhi jo fort e këndshme përsa u përket kontakteve shqiptare-raguzane. Kjo ngjarje është një grabitje që shqiptarët bëjnë ndaj raguzanëve në vitin 1278, kur tregtarët raguzanë ishin rrugës nga Bërskova për në Kotorr.<sup>38</sup> Dy prej tyre mesa duket shpëtojnë, kurse dy të tjerët kapen dhe grabiten nga shqiptarët.<sup>39</sup> Një rëndësi të veçantë kishin edhe transporti i lëndëve minerale. Si vende kryesore të përftimit të tyre ishin krahinat e Kosovës. Një pikë e rëndësishme ishte Novobërda, e cila kishte rëndësi edhe për tregtinë e mallrave të tjera, ku haset gjithashtu një komunitet raguzan mjaft i madh.<sup>40</sup> Rruga tjetër fillonte nga Lezha në derdhjen e Drinit,<sup>41</sup> pra në

<sup>35</sup> AAlb. II, dok. nr. 33, ref. 1.

<sup>36</sup> Luigi Villari, *The republic of Ragusa: an episode of the Turkish conquest*, With many Illustrations by William Hulton. London: J. M. Dent & Co 1904, f. 141.

<sup>37</sup> Po aty.

<sup>38</sup> *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, dok. nr. 386. (cituar më tej: AAlb. I)

<sup>39</sup> “*Et eundo sic venerunt Albanenses et assaliuerunt nos et ego, dictus Demetrius fui Captus, dictus vero vitagna et Zaicus non fuerunt capti, et si dictus Zaycus fuit robatus uel acceptum ei aliquid, nescimus*”, AAlb. I, dok. nr. 386; shih edhe C. Jireček, *Die Handelsstrassen und Bergwerke...*, f. 66, dok. nr. 225.

<sup>40</sup> M. Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore ...*, f. 125-126.

<sup>41</sup> I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...”, f. 346.



afërsi të portit të Shëngjinit dhe prej aty shkonte për në Shkodër, duke kaluar nga pika doganore e Vaut të Dejës.<sup>42</sup>

Përmes jugut të trojeve shqiptare duke filluar nga Durrësi kalonte *Via Egnatia*. Ajo vazhdonte për në Ohër dhe kalonte nëpër Selanik e më tej deri në Kostandinopojë.<sup>43</sup> Një degëzim që dilte prej saj vazhdonte në drejtim të Shën Gjinit dhe të Lezhës. *Via Egnatia* kishte një rëndësi të madhe përse i përket transportit të mallrave me karvanë sidomos në drejtim të Kostandinopojës, sepse ishte një rrugë disa qindra kilometra më e shkurtër për tregtarët raguzanë, por edhe për të tjerë, sesa e ashtuquajtura “Rruga e Raguzës”<sup>44</sup>, që kalonte përmes Ballkanit. Përveç kësaj, *Via Egnatia*, kalonte nëpër terrene më të ulëta malore dhe itinerari i saj, përveçse nëpër qendra më të vogla tregtare, vazhdonte edhe nëpër Selanik,<sup>45</sup> qytet dhe treg shumë i rëndësishëm jo vetëm në Mesjetë por edhe në periudhën osmane. Pikërisht gjatë kësaj periudhe ai e humbi disi rëndësinë, por për këtë do të flasim më poshtë. Sipas Jireček, një degë e *Via Egnatia* fillonte edhe në Apolloni dhe bashkohej me rrugën kryesore që vinte nga Durrësi. Kjo njihet edhe me emrin Rruga Perandorake (apo “Udha Mbret”), e cila para se të mbërrinte në Selanik, kalonte nëpër Ohër dhe nëpër lokalitete të tjera.<sup>46</sup>

Rruga e Myzeqesë ishte një tjetër itinerar i rëndësishëm, që përdorej nga karvanët dhe duke nisur nga Durrësi lidhte qendrat e ndryshme me Vlorën. Degëzime të kësaj rruge kalonin nëpër Berat dhe fushën e Myzeqesë, që njihej ndryshe edhe si “Fusha e Savrës”. Fusha e Myzeqesë ndahej nga lumi Seman në dy pjesë në Myzeqenë e Madhe, që shtrihej në veri të lumit Seman deri në Shkumbin dhe që kishte si qendër Beratin, dhe Myzeqenë e Vogël që shtrihej në jug të Semanit dhe kishte si qendër

<sup>42</sup> C. Jireček, *Die Handelsstrassen und Bergwerke ...*, f. 66.

<sup>43</sup> I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...”, f. 346.

<sup>44</sup> Jesse Cascade Howell, *The Ragusa Road: Mobility and Encounter in the Ottoman Balkans (1430-1700)*, Phil Diss. Harvard University Cambridge, Massachusetts: May 2017, f. 31.

<sup>45</sup> *Po aty*.

<sup>46</sup> Konstantin Jireček, “Valona im Mittelalter”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 174.

kryesore Fierin,<sup>47</sup> i cili në mesjetë nuk ekzistonte, por në vend të tij mund të përmendim Apoloninë dhe më vonë lokalitetin La Polina që përmendet nga raguzanët në vitin 1297.<sup>48</sup> Më tej, rruga kalonte për në Spinaricë, një qytet mesjetar me rëndësi në bregdetin e Adriatikut, buzë kanalit të lagunës së Nartës e që ruhet ende në emrin e fshatit Zvërnec të Vlorës.

Pas pushtimit osman të Vlorës me rrethina më 1417, Spinarica humbi rolin e saj dhe nuk përmendet më si qytet. Për të pushtuar Vlorën turqit kaluan pikërisht nëpër rrugën e Myzeqesë (*ad viam de Musachia*) dhe këto të dhëna na vijnë pikërisht nga raguzanët.<sup>49</sup>

Përsa i përket marrëdhënieve tregtare ndërmjet Vlorës dhe Raguzës, po e zgjerojmë pak më shumë diskursin duke përmendur edhe disa të dhëna për doganierët raguzanë në atë qytet. Në lidhje me këtë çështje po i referohemi vetëm disa shembujve në vazhdim. Si shembull të parë mund të përmendim doganën e Vlorës, ku për herë të parë ndeshen qiramarrës raguzanë të doganës në vitin 1345. Gjatë kësaj kohe, Vlora ishte nën sundimin e Stefan Dushanit, në kohën e të cilit një shoqëri (*societas*) e përbërë nga familjet e fuqishme raguzane Goçe dhe Lucaro kishte arritur të shtinte në dorë pothuajse të gjitha qiratë doganore në Serbi.<sup>50</sup> Në Vlorë gjatë kësaj kohe, më saktë në vitin 1346, në një dokument çlirimi nga detyrimet, të lëshuar nga Stefan Dushani, përmenden si qiramarrës të doganës raguzanët Marino de Dersa dhe Domagna de Golebo<sup>51</sup>, kurse më vonë qiraja e doganës deri në vitin 1350 ishte në dorën e raguzanit Micho de Bona<sup>52</sup>. Aty nga fundi i shek. XIV, në janar të vitit 1398 si qiramarrës i doganës së Vlorës, nga sunduesi i qytetit, pranohen Merksha Zharkoviç dhe Mihael de Resti.<sup>53</sup> Po në Vlorë në vitin 1406 përmendet Palë Pribiloviçi, i cili i paguan Merksha Zharkoviçit taksën e gjysmatarisë së

<sup>47</sup> Po aty, f. 171.

<sup>48</sup> DAD, *Diversa Cancelaria 1295*. (*codex non ligatus scriptus manu Marquardi Notarri*), në AAlb. I, dok. nr. 528.

<sup>49</sup> K. Jireček, “Valona im Mittelalter...”, f. 172.

<sup>50</sup> I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...”, f. 351.

<sup>51</sup> AAlb. II, dok. nr. 25.

<sup>52</sup> Po aty, dok. nr. 72.

<sup>53</sup> “(1398, circa 10. ianuarii. Aulonae). Mrkša (Zarkovič, dominus Avlonae) comiti et communi Ragusii Michaellem de Resti (Михиць Растнкъ) portoriorum suorum ab eodem conductorum rationem reddidisse sibi que in omnibus satisfacisse scribit.”. Po aty, dok. nr. 598; shih edhe I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...”, f. 351.

doganës për limanet e Pirgut dhe të Vlorës që i mbante si doganier.<sup>54</sup>

### **Marrëveshje tregtare ndërmjet raguzanëve dhe sunduesve të Arbërisë**

Nga marrëveshjet tregtare të fillimit të shek. XIII mund të përmendim marrëveshjen e Dimitrit, një princi të Arbërve (*Demetrio Arbanensi principii Demetrium judicem Albanorum*)<sup>55</sup>, i cili nëpërmjet marrëveshjes u premton raguzanëve tregti të lirë, pa paguar ndonjë gjë, në të gjitha proceset e tyre, qoftë atyre që kalojnë nëpërmjet trojeve të tij, qoftë atyre që lëvizin dhe jetojnë atje. Përveç kësaj ai u premton lëvizje të lirë dhe siguri, qoftë për tokë, qoftë për det.<sup>56</sup> Përsa i përket frazës së mësipërme “në të gjitha proceset e tyre” (*in omnibus iustitiis suis*), siç e pamë edhe më sipër, bëhet fjalë për proceset e tyre gjyqësore që do të zhvillohen me drejtësi. E ngjashme me këtë marrëveshje është edhe povelat e bërë midis Mihailit të Epirit me raguzanët në vitin 1206, pikat e së cilës janë:

Në qoftë se ndonjë raguzan vdes në Epir, pasuria e tij iu jepet trashëguesve të tij e jo arkës së mbretit;

Raguzanët janë të liruar nga taksa, vetëm paguajnë një taks të shitjes së mallit 3 përqind;

Në rastin se ndonjë anije e Raguzës copëtohet në bregun e Epirit, çdo plaçkë e marrë do t’u kthehet raguzanëve;

Në qoftë se ndonjë raguzan i mbetet borxh ndonjë epiroti nuk do të mundet kreditori të burgosë tjetër njeri përveç marrësin.<sup>57</sup>

Përveç këtyre kemi edhe novela dhe marrëveshje të ndryshme të bëra ndërmjet Stefan Dushanit dhe tregtarëve të ndryshëm raguzanë, për të cilat do të flasim më poshtë.<sup>58</sup> Marrëveshje të tjera kishte edhe me familjet fisnike sunduese, si për shembull me Balshajt sidomos në gjysmën e dytë të shek. XIV por edhe më pas.<sup>59</sup> Po ashtu marrëdhënie të

<sup>54</sup> *AAlb.* II, dok. nr. 787. Shih dokumentin origjinal në gjuhën sllave: Konstantin Jireček, *Spomenik XI, Srpska Kraljevska Akademija*, Beograd: 1892, dok. nr. 40, f. 50-51.

<sup>55</sup> *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-II-18, “Marrëveshje e panjohur e Dubrovnikut me sunduesit e Shqipërisë në fillim të shek. XIII-të”, f. 2.

<sup>56</sup> “...ut ipsi Ragusei salvi et securi ambulat per totam terram meam sine (n) ullo datio/ in omnibus iustitiis suis tam per terram quam per mare liberi et securi...”, Po aty, f. 6.

<sup>57</sup> Po aty, f. 8.

<sup>58</sup> *AAlb.* II, dok. nr. 33.

<sup>59</sup> M. Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore ...*, f. 95.

shumta ekonomike-tregtare kishte me familjet e tjera të rëndësishme fisnike si me Topiajt, Aranitët Dukagjinët, etj.<sup>60</sup>

Edhe Kastriotët kishin me Republikën e Raguzës marrëdhënie tregtare të qenësishme dhe për ta ilustruar shkurtimisht po sjellim më poshtë një dokument të datës 25 shkurt 1420, me anë të cilit Gjoni me bijtë zotoheshin se lejonin tregtarët raguzanë që të kalojnë nëpër territorin e tij dhe të bëjnë tregti në Shufada që aso kohe ai e kishte nën zotërim.<sup>61</sup> Në dokument Gjoni u premtonte mbrojtje dhe siguri tregtarëve raguzanë deri në Prizren dhe në këmbim të kësaj sigurie ai kërkon vetëm një të dhjetën, duke dhënë edhe specifikime si p.sh.: për një kuintal cohë dy dukatë dhe për një kuintal grurë 1 hiperper.<sup>62</sup> Po mjaftohemi këtu vetëm me përmendjen e disa prej tyre, pasi për këto marrëdhënie tregtare ndërmjet Raguzës dhe familjeve fisnike sundimtare arbërore do të flasim në mënyrë specifike në punime të tjera, ngaqë zgjerimi i mëtejshëm do ta kapërcente kufirin e këtij artikulli.

### **Tregtia me mallra të ndryshme**

Më poshtë hedhim vështrimin edhe në tregtimin e disa mallrave duke nisur me atë të kripës dhe më pas të drithit si dy artikuj më të rëndësishëm që bliheshin në Arbërinë mesjetare, duke vazhduar me mallra të tjera e në përfundim me tregtinë e tekstileve dhe të bizhuterive.

### **Tregtia e kripës**

Kripa në mesjetë zë një vend të rëndësishëm në ekonomi dhe ishte një ndër artikujt më të kërkuar që përdorej madje për shkëmbim mallrash, pra si mjet pagimi. Studiuesit e ndryshëm e quajnë kripën si “nafta e

<sup>60</sup> Shih disa të dhëna për këto marrëdhënie edhe tek vepra e sipërcituar e historianit kosovar Muhamet Mala: *po aty*, f. 97-106.

<sup>61</sup> Shih dokumentin sllavisht të përkthyer në shqip nga: Át Gjon Shllaku OFM, *Shqyptari – Frati – Shqypnija*, përgatitën për botim Át Vitor Demaj OFM, Prof. dr. Aljula Jubani, Át Mirash Marinaj OFM, Shkodër: Botimet Françeskane, 2018, f. 106-107. Këtë dokument tashmë e kemi në artikullin me titull: Edmond Malaj, “Kastriotët dhe Raguzat”, në *Studime historike*, nr. 3-4/2020, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2021.

<sup>62</sup> Gj. Shllaku, *Shqyptari – Frati – Shqypnija...*, f. 96.

mesjetës”.<sup>63</sup> Në histori, kripën e hasim në shumë përdorime që arrijnë një gamë të gjerë, që nga ato kultike e deri në kuzhinë<sup>64</sup>, por këtu duhet të kufizohemi në përdorimin e kripës në Mesjetë<sup>65</sup>, të cilën mund ta ndajmë si më poshtë:

1. Kripa si mjet konservimi për ushqime sidomos për peshk dhe mish;

2. Kripa si ushqim për kafshë;

3. Kripa si mjet për regjien e lëkurëve dhe në ngjyrosje;

4. Kripa si mjet pagimi;

5. Kripa si mjet pastrimi;

6. Kripa në Magji;

7. Kripa si erëzues në gatime.

Kripa pra ishte një produkt shumë i rëndësishëm tregtie dhe çështjet në lidhje me këtë mall ishin të përcaktuara me ligjet e kohës. Për shembull, përsa i përket Republikës së Raguzës qysh në shek. XIII u futën në statutet e saj rreth 6 pasazhe që kishin të bënin me tregtinë e kripës.<sup>66</sup> E kemi fjalën këtu për kripën e detit, pasi kripa e gurit që gjendej në brendësi të Ballkanit kishte në mesjetë vetëm një burim të njohur, atë të Tuzlës (Sol) në Bosnjën Veriore, burim që njihej mirë që në kohën e perandorit Konstantin.<sup>67</sup> Vende që kishin një rëndësi të veçantë në prodhimin dhe eksportimin e kripës ishin p. sh. Hungaria dhe Vllahia.<sup>68</sup> Edhe trojet shqiptare kanë sasi të konsiderueshme të kripës së gurit, si p. sh. shtresat në Mengaj të Kavajës, Dumre të Elbasanit, apo në Dhrovjan të Sarandës<sup>69</sup> etj. etj., por mesa duket këto vende me kripë nuk njiheshin akoma në Mesjetë. Kripa e detit nxirrej nëpër shumë vende të

<sup>63</sup> Luan Malltezi, “Konflikte për tregjet e kripës në kohën e Skënderbeut”, në *Gjergj Kastrioti – Skënderbeu në historinë e shqiptarëve*, botim i Fakultetit Histori-Filologji, Tiranë: Progres, 2005, f. 84.

<sup>64</sup> Matthias Jacob Schleiden, *Das Salz: seine Geschichte, seine Symbolik und seine Bedeutung im Menschenleben*. Eine monographische Skizze. Leipzig: Wilhelm Engelmann, 1875, f. 1-101.

<sup>65</sup> Anne Schulz, *Essen und Trinken im Mittelalter (1000-1300)*: Literarische, kunsthistorische und archäologische Quellen. Berlin/Boston: Walter de Gruyter 2011, f. 666-675.

<sup>66</sup> Veronika Wengert, *Kroatische Adriaküste. Das Meer immer im Blick*, Ostfildern: DuMont, 2010, f. 102.

<sup>67</sup> K. Jireček, *Die Bedeutung von Ragusa in der Handelsgeschichte ...*, f. 24.

<sup>68</sup> *Po aty*.

<sup>69</sup> Ernest Bushati & Besnik Ostrosi, “Kripa e Gurit”, në *Fjalor Encikopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë: 1985, f. 550.

bregdetit Adriatik dhe Jonian duke filluar sidomos nga Quarnero (sot Kvarneri në Kroaci) e deri në Pelopones.<sup>70</sup> Të rëndësishme janë për Mesjetën kriporet e Durrësit dhe të Vlorës, për të cilat do të flasim më poshtë si dhe kriporet e Ulqinit. Përveç tyre kishte edhe kripore të tjera më të vogla, që nuk e kishin rëndësinë e atyre të lartpërmendura.

Kriporet e Durrësit janë të përmendura që në shek.XI nga kronistja bizantine Ana Komnena,<sup>71</sup> por mesa duket ato janë më të vjetra, e për këtë si shembull mund të përmendim zonat për nxjerrjen e kripës në jug të qytetit, afër Karpenit të cilat shërbenin për këtë punë që nga kohërat e hershme e deri në shek. XVIII e më vonë<sup>72</sup>. Kriporet e Durrësit më vonë - sidomos gjatë periudhës së venedikasve - qenë të vetmet, të cilat furnizonin tregjet që ndodheshin nëpër qytete dhe në grykat e lumenjve të Arbërisë Veriore, si për shembull atë të Shirqit dhe të Lezhës, siç theksohet edhe në një dokument të datës 31 tetor 1401.<sup>73</sup> Sasia e kripës që tërhiqej nga Durrësi ishte shumë e madhe. Si shembull, mund të përmendim këtu rastin e një tregtari raguzan, i cili në vitin 1248 kërkonte të tërhiqte nga kriporet e Durrësit një sasi kripe të madhe (sipas Malltezit, rreth 593 tonë).<sup>74</sup> Ky tregtar raguzan quhej Paulus de Volcina dhe e priste kripën nga Paskal Saripi Durrsaku (domino Pascali Sarippi Dirrachii). Kripa ishte në dy cilësi, pjesa më madhe kripë e zezë (*decem milliaria salis bruno*) dhe një sasi kripe të bardhë (*usque milliario uno de sale albo*).<sup>75</sup>

Një vështirësi për eksportimin e këtij malli pati në vitin 1272, kur në Arbëri ishin vendosur Anzhuinët, të cilët themeluan të ashtuquajturën

<sup>70</sup> K. Jireček, *Die Bedeutung von Ragusa in der Handelsgeschichte ...*, f. 24.

<sup>71</sup> L. Malltezi, "Konflikte për tregjet e kripës...", f. 85.

<sup>72</sup> Marco Moderato, *Dinamiche insediative nel paesaggio storico di Durazzo fra età classica e tarda antichità*, Phil. Diss. Università di Foggia (Dipartimento di Studi Umanistici) A.A. 2014-2015, f. 249.

<sup>73</sup> *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*. Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Parstis Primae: Saeculum XIV complectentis. Tomus Tertius: Ab anno MCCCXCVI ad annum MCDVI. Centro internazionale di Studi Albanesi Palermo/ Istituto Universitario Orientale Napoli/ Istituto di Studi Albanesi del' Università di Roma/ Fondazione Giorgio Cini Venezia/ Ponteficio Istituto di Studi Orientali Roma/ Albanien Institut, Universität München/ Südost Institut, München / Institut für Geschichte und Kultur des Nahen Orients, sowie für Turkologie, Universität München. München: Rudolph Trofenik 1968, dok. nr. 915, f. 273-274 (cituar më tej: AVV I/III), dok. nr. 915, f. 273-274.

<sup>74</sup> L. Malltezi, "Konflikte për tregjet e kripës...", f. 87.

<sup>75</sup> *AAlb*. I, dok. nr. 188.

“Mbretëri të Arbërisë” (*Regnum Albaniae*). Aty lindën konflikte ngaqë Karl Anzhu u përpoq për të monopolizuar tregtinë e kripës dhe si rrjedhojë mënjanoi tregtarët e huaj, si raguzanë, venedikas etj. Në kushte të tilla piratët sllavë që ishin aleatë të Republikës së Raguzës, filluan të sulmonin anijet e ngarkuara me kripë nga Durrësi dhe t’i sillnin ato në Raguzë.<sup>76</sup> Këto veprime piraterie shkaktuan një përkeqësim të madh të marrëdhënieve ndërmjet Mbretërisë së Napolit dhe Republikës së Raguzës. Për t’u hakmarrë Mbretëria e Napolit sulmoi anijet raguzane që ndodheshin nëpër portet e Italisë së Jugut.<sup>77</sup>

Përsa u përket tregjeve, në lidhje me tregtinë e kripës duhet të përmendet se në hapësirën midis grykëderdhjes së lumit Neretva dhe atij të Bunës, Shën Shirqi ishte një nga portet dhe vendet kryesore të tregtisë së saj, së bashku me Kotorin dhe Dubrovnikun. Raguzanët luanin një rol shumë të rëndësishëm në tregtinë e këtij produkti, sidomos në Drijeva në veri (në grykëderdhjen e Neretvas) dhe në Shën Shirq në jug. Në këto vende ata nuk kishin vetëm tregtinë e kripës por edhe dhënien me qira të vendit të shitjes në këto dy tregje kripe.<sup>78</sup> Kjo tregti nuk ishte e vogël dhe nuk është për t’u çuditur që në Durrës dhe në Spinaricë ishin të pranishëm fisnikë (*mobiles*) raguzanë qysh në shek. XIII.<sup>79</sup> Në Spinaricë ata kishin funksionin e *consoles* dhe dërgoheshin aty që të qëndronin për disa muaj, në koloninë e atyshme raguzane.<sup>80</sup> Si shembull mund të përmendet këtu për vitin 1301 Dobroslavus de Kaliq (*de Calich*), i cili qe bërë konsull raguzan në Spinaricë për tre muaj me një rrogë prej 20 perperësh dhe që kishte si detyrë që të kontrollonte me kujdes të gjitha mallrat që silleshin në Spinaricë nga raguzanët.<sup>81</sup> Një vit më vonë, më 1302, vendoset konsull në Spinaricë, Martinus de Martinus.<sup>82</sup>

Tregu i Spinaricës mori një rëndësi të madhe kryesisht gjatë

<sup>76</sup> L. Malltezi, “Konflikte për tregjet e kripës...”, f. 87.

<sup>77</sup> Po aty.

<sup>78</sup> I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...”, f. 347.

<sup>79</sup> Dokumente të viteve 1243, 1248 dhe 1249 në Tadija Smičiklas, *Codex diplomaticus Regni Croatiae, Dalmatiae et Slavinae*, Vol. IV, Diplomata annorum 1236-1255, Continens. Sabrao i uredio Tadija Smičiklas, Izdala Jugoslavenska akademija znanosti i umjetnosti, Zagreb: Tisak Dioničke biskare, 1906; shih edhe *AAIb*. I, dok. nr. 179, 188, 192.

<sup>80</sup> *AAIb* I. dok. nr. 540; shih edhe I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...”, f. 350.

<sup>81</sup> *AAIb*. I. dok. nr. 534

<sup>82</sup> Po aty, dok. nr. 540.

periudhës së vështirë që shkaktoi konflikti i sipërpërmendur ndërmjet Mbretërisë së Napolit dhe Republikës së Raguzës, gjatë gjysmës së dytë të shek. XIII. Ngaqë tregtarët e Raguzës nuk lejoheshin që të furnizoheshin me kripë në Durrës dhe në tregjet e tjera të Arbërisë që ishin nën Anzhutë, si rrugëzgjdhje për momentin ata gjetën tregun e Spinaricës, i cili në atë kohë ishte nën zotërimin e Bizantit. Më vonë edhe Spinarica kaloi nën zotërimin e Anzhuinëve.<sup>83</sup> Përveç vendeve që përmendëm më sipër, raguzanët ishin të pranishëm edhe në tregtinë e kripës që bëhej në Prishtinë. Aty në vitin 1414 kishte një konkurrencë midis tregtisë së kripës së gurit që vinte nga Hungaria, dhe asaj që vinte nga bregdeti.<sup>84</sup>

Tregjet e kripës kishin një rëndësi të jashtëzakonshme, si rrjedhojë ndodhte shpesh që të ndizeshin konflikte ndërmjet sundimtarëve të ndryshëm, ngaqë ata donin që t'i kapnin këto tregje dhe t'i kishin sa më tepër nën sundimin dhe kontrollin e tyre.<sup>85</sup> Tregtia e kripës në tregun e Shën Shirqit u sillte raguzanëve jo vetëm marrëdhënie intensive me shqiptarët përreth këtij tregu, por edhe marrëdhënie intensive më në brendësi të truallit shqiptar në ato vende ku prodhohej kripa, sidomos në Durrës dhe në Vlorë.<sup>86</sup> Shën Shirqi ishte një vend shumë i rëndësishëm, jo vetëm për tregtinë e atyshme të kripës por edhe si pikë transiti mallrash dhe si një ndër stacionet e rrugës tregtare për në Prizren. Kjo lidhje ishte shumë e rëndësishme për Raguzën, sepse në afërsi të Prizrenit, në Novobërdë kishte tashmë një ekonomi të rëndësishme të lidhur me nxjerrjen e mineraleve.<sup>87</sup> Kripa që merrej në Shirq shkonte jo vetëm në Raguzë, por edhe në shumë vende të tjera të huaja.<sup>88</sup>

Me tregtinë e kripës merreshin kryesisht njerëz që i përkisnin shtresës së mesme dhe shtresës së ulët të patricëve të qytetit të Raguzës, ngaqë kjo tregti bëhej kryesisht në zonën lindore të Adriatikut, pra nuk ishte një tregti e distancave të largëta. Krahas kripës ata bënin tregti edhe me mallra ushqimore të tjera, si me drithë, mish, djathë etj.<sup>89</sup> Këta persona ishin jo vetëm tregtarë por edhe agjentë të tregtarëve të fuqishëm

<sup>83</sup> L. Malltezi, "Konflikte për tregjet e kripës...", f. 87.

<sup>84</sup> K. Jireček, *Die Bedeutung von Ragusa in der Handelsgeschichte ...*, f. 25.

<sup>85</sup> L. Malltezi, "Konflikte për tregjet e kripës...", f. 84.

<sup>86</sup> I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 347.

<sup>87</sup> Po aty, f. 352.

<sup>88</sup> L. Malltezi, "Konflikte për tregjet e kripës...", f. 86.

<sup>89</sup> I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 348.



e të pasur të Raguzës, të cilët ishin të stacionuar nëpër tregjet e qyteteve. Ata ishin të gatshëm të bënin kontrata qoftë me furnitorët, qoftë me pronarët e anijeve.<sup>90</sup> Ndërsa familjet e mëdha të pasura të qytetit merreshin me tregtinë e largët dhe me mallra luksi që i tregtonin ndërmjet Italisë dhe Ballkanit.<sup>91</sup>

Por në shek. XIV kjo shtresë, pra shtresa e mesme dhe patricët e ulët, që ndryshe quhej edhe *cives de populo*, erdhi duke u fuqizuar e zmadhuar gjithnjë e më tepër, dhe tashmë ndahej në nënshtresa të ndryshme sociale. Ishin kryesisht individë të këtyre shtresave që kishin lidhje me qendrat shqiptare të Shirqit, Lezhës, Durrësit dhe Vlorës. Ata përfshinin brenda këtij grupi që nga detarët e thjeshtë deri tek tregtarët e pasur, pronarët dhe gjysmëpronarët e anijeve të transportit, e deri tek tregtarët më të pasur.<sup>92</sup> Duhet të theksohet se, familjet që i përkisnin *cives de populo* ishin në fakt edhe fisnikë joraguzanë, por që vinin nga qytete të tjera në afërsi të Raguzës dhe që fitonin nënshtetësinë raguzane.<sup>93</sup> Si të tillë ata duhej të ishin të pranishëm në qytet, por nuk kishin të gjitha të drejtat e fisnikërisë vendase, vetëm ato të *cives de populo*.

Ndër palët kontraktuese, krahas vendasve hasen edhe hebrenj nga Durrësi që merreshin me tregtinë e kripës, siç e pasqyrojnë edhe shembujt më poshtë. Më datë 24 mars 1281 ekziston një akt i regjistruar në administratën e Raguzës ku thuhet se, një farë “Nikolla Martini (ose Nikololao Marini) i Famullisë së Santa Maria Nova, nga Venecia ishte në marrëdhënie me dy hebrenj nga Durrësi, të quajturit Leon dhe Mishel (Mikel)”.<sup>94</sup> Në një akt tjetër të datës 11 gusht 1319 po nga komuna e Raguzës, shkruhet se kjo komunë ishte gati të blinte një ngarkesë me kripë të një hebreu nga Durrësi.<sup>95</sup> Pra, judejtë e Durrësit bënin tregti me Italinë, Serbinë dhe me Dubrovnikun (Raguzën)<sup>96</sup>, eksportonin kripë dhe importonin tekstile të ndryshme.<sup>97</sup>

Tani përta u përket konkretisht individëve që merreshin me këtë

<sup>90</sup> L. Malltezi, “Konflikte për tregjet e kripës...”, f. 86.

<sup>91</sup> I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...”, f. 348.

<sup>92</sup> Po aty, f. 349.

<sup>93</sup> Po aty, f. 364.

<sup>94</sup> Apostol Kotani, *Hebretë në Shqipëri gjatë shekujve / The Hebrews in Albania during the Centuries*, Tiranë: Eureka, 1996, f. 20.

<sup>95</sup> Po aty, f. 9, ref. 6.

<sup>96</sup> J. Luetić, “Die Republik von Ragusa ...”, f. 20.

<sup>97</sup> S. Marcus, “Durazzo...”, f. 38-39.

tregti po përmendim në vazhdim edhe disa raste konkrete. Në vitin 1333 përmendet në disa dokumente tregtari fisnik Savinus de Bonda që merrej me tregtinë e kripës në Shën Shirq, Lezhë dhe Vlorë.<sup>98</sup> Në një dokument të 12 korrikut të vitit 1333 thuhet se Paul de Martinussio duhej të sillte nga Vlora për në Shën Shirq një sasi kripe për llogari të Save de Bondas.<sup>99</sup> Po në të njëjtin dokument përmendet edhe një ngarkesë kripe e Durrësit, e cila ishte shitur nga Junio de Lukario dhe Junio de Volkasio në tregun e Lezhës sipas masës së këtij qyteti, tregtarit Save de Bonda. Për të shlyer doganën që i paguhej aso kohe mbretit serb, nën sundimin e të cilit në atë kohë ishte porti i Shën Shirqit, Junio de Lukario dhe Junio de Volkasio duhej t'u dorëzonin doganierëve një sasi të caktuar kripe që në dokument nuk jepet me shifra.<sup>100</sup> Savinus de Bonda përveçse merrte, nganjëherë, edhe çonte kripë në Arbëri. Kështu në një dokument të datës 25 mars thuhet se një sasi kripe nga Shibeniku apo nga Zara, që ishte pronë e Sergolo de Bonas do të transportohej me anijen e Savinus de Bonas për në krahinën e Drinit, dhe nëse atje deti do të ishte i egër, ishte rënë dakord që të mos hynte në Drin, por të shkonte pak më tej në portin e Shën Gjinit. Nëse do të mundej, mund të shkonte me ngarkesë ose në Drin ose në tregun e Lezhës ku mund të shkarkonte, por nëse jo, mund ta shkarkonte ngarkesën në Shën Gjini.<sup>101</sup>

Po ashtu për tregtinë e kripës njihej edhe Marinus de Bacante, i cili e merrte kripën dhe e dërgonte nëpër krahinat e Drinit dhe të Bunës.<sup>102</sup> Ndër transportuesit përmendet Paulus Martinusio, i cili e merrte kripën nga Vlora dhe e transportonte për në Durrës, Dubrovnik dhe në Shën Shirq,<sup>103</sup> siç e pamë edhe në dokumentin e mësipërm.<sup>104</sup> Po në këtë shekull, në vitin 1360-1361, kemi të dokumentuar edhe tregtinë e kripës të bërë nga Tripe de Goliebo dhe Matcho de Vita de Georgio me qytetin e

<sup>98</sup> I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 360.

<sup>99</sup> DAD, Div. Canc. 1334/1, në AAlb. I, dok. nr. 770.

<sup>100</sup> DAD, Div. Canc. 1334/1, në AAlb. I, dok. nr. 772.

<sup>101</sup> DAD, Div. Canc. 1334/III: "*Sal Sebenichi vel de Jadra, proprietaria Sergoli de Bona vehitur in navi Savini de Bonta. „ad mensuram modiorum Drini”, „Si esset rnamgnum mare ad fulcem” non debet „intrare ad folcium Drini”, sed ulterius ad „portum Medoua;” si potest „usque ad Drinum vel Allessio” „si poterit intrare in folcem de Lessio cum toto honere”, „usque ad mercatum Lessii;” si non poterit exonerare ibi; vadet; „ad portum Medue.”*, në AAlb. I, dok. nr. 800.

<sup>102</sup> I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 361.

<sup>103</sup> Po aty, f. 362.

<sup>104</sup> DAD, Div. Canc. 1334/1, në AAlb. I, dok. nr. 770.

Vlorës të cilët gjatë asaj periudhe gjendeshin aty.<sup>105</sup> Me tregtinë e kripës në trojet arbërore merreshin edhe pjesëtarë të familjes fisnike *Georgio*. Si person shumë aktiv në lidhje me këtë tregti mund të përmendim Jache de Georgio de Georgio (†1377) që e bënte atë me anijet e veta, ndërmjet Vlorës dhe Shën Shirqit.<sup>106</sup> Tregtia e kripës ndërmjet Raguzës dhe trojeve shqiptare nuk u ndërpre gjatë gjithë mesjetës duke vazhduar edhe pas pushtimit osman të Arbërisë. Krahas kripës një produkt tjetër i rëndësishëm që tregtohej shumë me Raguzën ishin edhe drithërat.

### Tregtia e drithit

Prodhimi i drithit në Arbërinë mesjetare ishte i ndryshëm nga krahina në krahinë, sipas cilësisë dhe karakteristikave të tokave të punueshme. Tokat e punueshme ndaheshin kryesisht në tri kategori: 1) *fushat dhe rrafshinat e mëdha që gjendeshin në afërsi të bregdetit*,<sup>107</sup> të cilat edhe pse ishin me sipërfaqe të mëdha për nga cilësia nuk ishin më të mirat, pasi u mungonte humusi<sup>108</sup>; 2) *luginat e lumenjve*,<sup>109</sup> të cilat shtriheshin nëpër zona kundrinore anash lumenjve dhe ishin më të mirat<sup>110</sup>, dhe 3) *sipërfaqet e mbjella nëpër zonat malore*<sup>111</sup>, të cilat përbëheshin nga ngastra të vogla me cilësi të ndryshme.<sup>112</sup> Nëse do t'i referohemi E. Sedlmayr, i cili jep sipërfaqen e tokës së punueshme në shek. XIX, afërsisht deri në 250 hektar, duke mos përfshirë këtu kullotat. Edhe pse kjo shifër i përket një periudhe më të vonë, jam i mendimit që

<sup>105</sup> “*Eadem die litterae mittuntur ex parte rectoris et parvi consilii “Tripe de Goliebo, Matcho de Vita de Georgio et aliis mercharioribus de Ragusio existentibus in Auelona et locis circumpositis”*”, AAlb. II, dok. nr. 160.

<sup>106</sup> I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...”, f. 362.

<sup>107</sup> Ernst. C. Sedlmayr, “Die Landwirtschaft Albaniens”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot, 1916, f. 5.

<sup>108</sup> Bogumil Hrabak, “Eksportimi i drithërave nga Shqipëria në shekujt XIII, XIV dhe XV”, në *Gjurmime Albanologjike*, nr. 1-2, Instituti Albanologjik-Prishtinë: 1970, f. 24.

<sup>109</sup> E. Sedlmayr, “Die Landwirtschaft Albaniens”, f. 9.

<sup>110</sup> B. Hrabak, “Eksportimi i drithërave nga Shqipëria ...”, f. 25.

<sup>111</sup> E. Sedlmayr, “Die Landwirtschaft Albaniens”, f. 9.

<sup>112</sup> B. Hrabak, “Eksportimi i drithërave nga Shqipëria ...”, f. 25.

kjo sipërfaqe e punueshme duhet të ketë qenë e ngjashme edhe me rrethanat mesjetare.

Tregtia e drithit në Raguzë i ishte lënë më tepër iniciativës private, ndryshe nga Venediku, ku kjo tregti kontrollohej kryesisht nga shteti.<sup>113</sup> Drithi që dërgohej në Raguzë kishte një rëndësi të madhe, dhe në kohëra urie, personat që e dërgonin këtë drithë në republikë përfitonin benefice nga shteti. Si shembull, mund të përmendim këtu një anëtar të familjes Sorgo nga Kotorri, por me origjinë të vjetër nga Redoni i Durrësit, i cili në vitin 1292, gjatë periudhës së një mungese të madhe të bukës dërgoi një sasi meli dhe drithërash të tjera në Raguzë, dhe si rrjedhim, pati favorizime nga Këshilli i Madh i Raguzës.<sup>114</sup>

Në Raguzë, tregtia e drithit gjendet e dokumentuar nëpër raporte dhe procesverbale të Këshillave, nëpër përmbledhjet e punëve shtetërore.<sup>115</sup> Dubrovniku e importonte drithin nga vende të ndryshme dhe për sasira të mëdha republika dërgonte sindakë të veçantë në Pulje, Sicili, në “Romania” dhe herë pas here edhe në Azinë e Vogël. Krahas këtyre vendeve, ndër më të rëndësishmet për furnizimin me drithë të qytetit të Raguzës ishte trualli shqiptar sidomos zonat e Shqipërisë së Mesme, deri në jug, d.m.th., krahina midis Durrësit dhe Vlorës.<sup>116</sup> Drithi shqiptar edhe pse me një kualitet më të dobët, për shkak të terrenit kryesisht malor, pra jo shumë të përshtatshëm për kultivimin e tij, ishte gjithsesi më i lirë se ai i fushëdrithoreve të mëdha (si p.sh. Bosnja) eksportohej në sasi të konsiderueshme.<sup>117</sup>

Në vitin 1301, Këshilli i Rogatëve vendos që të gjithë ata persona që donin të shkonin në Vlorë, Spinariçë dhe Durrës, për të marrë drithë me anijet e tyre, ishin të lirë të shkonin ashtu si u pëlqente atyre dhe në këmbim mund të dërgonin në ato vende rroba luksi (*drapariam et fustagnos*) e mallra të tjera.<sup>118</sup>

<sup>113</sup> Po aty, f. 24.

<sup>114</sup> “Sorgo da Cattaro, antichi da Redoni d’ Albania, beneficiato per il gran consiglio, per haver portato gran summa di sorgo et altre biave a Ragusa, in tempo di gran carestia; che si trovava in Ragusa dell’ anno 1292.” “Annales Ragusini Anonymi item Nicolai de Ragnina”, në *Scriptores*, Volumen I (=Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium, Volumen XIV, Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalium, Zagabriae: 1883), f. 185.

<sup>115</sup> B. Hrabak, “Eksportimi i drithërave nga Shqipëria ...”, f. 24.

<sup>116</sup> I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...”, f. 350.

<sup>117</sup> B. Hrabak, “Eksportimi i drithërave nga Shqipëria ...”, f. 23.

<sup>118</sup> *AAIb.* I, dok. nr. 533.

Sasia më e konsiderueshme e drithit eksportohej nëpërmjet Veriut dhe këtu kemi parasysh portet e Tivarit dhe të Ulqinit.<sup>119</sup> Një pikë tjetër e rëndësishme ishte edhe porti lumor tek manastiri i Shën Shirqit dhe i Shën Bakut, mbi Bunë. Tregjet më të rëndësishme të drithit në mesjetë gjendeshin sidomos në grykëderdhjen e Shkumbinit (që nga raguzanët quhej Vrego) dhe të Semanit (që nga raguzanët quhej Dievolo).<sup>120</sup>

Si treg i rëndësishëm i drithit mbahej edhe Shufadaja që ishte port e doganë në grykëderdhje të Ishmit dhe që nga viti 1415 i përkiste Gjon Kastriotit. Në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XV kjo zonë ishte shndërruar tashmë në një pikë transite e rëndësishme tregtie dhe për Republikën e Raguzës konsiderohej si një treg shumë i madh dhe i rëndësishëm për drithërat, por edhe për drurin. Në atë lokalitet ishin vendosur me banim tregtarë raguzanë<sup>121</sup>, që sigurisht shërbenin si agjentë tregtarë të Raguzës. Bile më vonë kjo marrëdhënie tregtare dhe politike u intensifikuan edhe më tepër me Kastriotët, të cilët u bënë qytetarë të Raguzës. Madje, Skënderbeu ndërtoi edhe kështjellën në kepin e Rodonit që do t'i shërbente për mbrojtën e atij territori<sup>122</sup>, dhe për interesa tregtare.

Një vend tjetër i rëndësishëm i tregtisë së drithit ishte Spinarica e sipërpërmendur, e cila ndodhej në veri të Vlorës në afërsi të grykëderdhjes së Vjosës.<sup>123</sup> Në lidhje me Vlorën mund të themi, që ky qytet ishte një vend i rëndësishëm magazinimi gruri, ku vinin e ngarkoheshin anije nga jashtë. Përsa u përket anijeve raguzane, këtu mund të përmendet rasti i detarit raguzan Gojслав Milloseviq, i cili merr një salvakondukt nga Johan Jaratek, vëllai i admiratit të Vlorës, me anë të cilit ai ishte i lirë dhe i siguruar nga ana e Merkshë-s për të udhëtuar për në Vlorë dhe për të ngarkuar grurë.<sup>124</sup> Gojslavi gjatë pranisë së tij në Vlorë nuk do të shqetësohej as nga zoti i Vlorës e as nga vasalët e tij, e nëse do t'i ndodhte ndonjë gjë, a do t'i shkactohej ndonjë dëm apo pengesë në këtë udhëtim nga ana e Merkshë-s, apo nga vasalët e tij,

<sup>119</sup> B. Hrabak, "Eksportimi i drithërave nga Shqipëria ...", f. 24.

<sup>120</sup> I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 350.

<sup>121</sup> A. Saraçi, *Tregtia e Shkodrës me Republikën e Venecias ...*, f. 150.

<sup>122</sup> *Po aty*, f. 151.

<sup>123</sup> K. Jireček, "Valona im Mittelalter ...", f. 174; I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 350.

<sup>124</sup> *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV (1406-1410)*, vëll. II, Pjesa e parë, Transkriptuan dhe përkthyen Injac Zamputi, Pranvera Bogdani, Redaktoi dhe përgatiti për botim Edmond Malaj, Tiranë: ASA, Instituti i Historisë, 2019, dok. nr. 119.

atëherë i sipërpërmenduri Johan detyrohej të përgjigjej dhe të paguaj me pasurinë e vet, të gjitha shpenzimet, dëmin dhe interesin që do t'i shkakttoheshin Gojslavit.

Ndër tregtarë të tjerë raguzanë të drithit, krahas Tripe de Goliebo-s († 1374) të përmendur tashmë, qenë edhe Stepe de Georgio dhe Nichus de Mesagna, të cilët e gjenin drithin nëpër krahinat e Shkumbinit e të Semanit dhe e dërgonin atë në Dubrovnik e në Venedik.<sup>125</sup>

Tregtari Marince Miroshi nga Tivari përmendet në një dokument raguzan të datës 19 shkurt 1407, në lidhje me pagesën ndaj tij për hamejtë dhe magazinat për grurin që do të sillte në Raguzë brenda prillit të vitit 1407. Nëse ai nuk do ta sillte grurin në afatin e caktuar do t'i jepte si dënim bashkisë së Raguzës një perper për çdo stare.<sup>126</sup> Përveç grurit, në lidhje me drithërat kishte rëndësi edhe tregtia e melit. Në një dokument po të vitit 1407 një brigandinë raguzane, krahas të tjerash i caktohej detyra që të shkonte në Vlorë e në Pirg për t'u interesuar në lidhje me çmimet dhe sasinë që mund të gjendeshin në ato porte, me qëllim blerjeje.<sup>127</sup>

### **Tregtia e mishit**

Për tregtinë e mishit vendet kryesore në Shqipëri ishin zonat e Shkumbinit e të Semanit dhe nga tregjet e këtyre vendeve raguzanët importonin mish kryesisht për furnizimin e qytetit të tyre, por kur nevojat e qytetit ishin plotësuar si duhej, disa tregtarëve u jepej leje që ta tregtonin mishin e tregjeve të Arbërisë në Venedik.<sup>128</sup> Tregtarët raguzanë Tripe de Goliebo, Stepe de Georgio\* dhe Nichus de Mesagna, merreshin edhe me tregti mishi, të cilin e gjenin nëpër krahinat e Shkumbinit e të Semanit dhe e dërgonin atë në Dubrovnik e në Venedik.<sup>129</sup>

<sup>125</sup> I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 360.

<sup>126</sup> *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV....*, vëll. II/1, dok. nr. 105.

<sup>127</sup> *Po aty*, dok. nr. 128.

<sup>128</sup> I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 350.

\* *Stepe de Georgio* ishte i biri i *Give Mathei de Georgio*, i cili kishte aktivitet tregtar të dendur sidomos në Shën Shirq dhe në Prizren.

<sup>129</sup> I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 360.

## Tregtia e dyllit, lëkurës dhe e drurit

Tregtarë raguzanë sillnin në tregjet shqiptare dyllë<sup>130</sup>, lëkura dhe sasira të mëdha druri, që shërbenin ndër të tjera edhe për ndërtimin e anijeve. Vendi kryesor i shkarkimit të këtyre mallrave ishte kryesisht tek grykëderdhja e Bunës në Velipojë, e më tej në atë të Drinit në Shëngjin.<sup>131</sup>

Druri ishte gjithashtu një ndër mallrat që eksportohej e importohej ndërmjet Raguzës dhe Arbërisë. Tregtia e drurit ndërmjet dy vendeve ishte aktive gjatë gjithë Mesjetës. Më 9 dhjetor të vitit 1462 përmendet një varkëtar raguzan i quajtur Radoe Miloseviq (Radoe Milosseuich), i cili pasi kishte marrë me qira një anije me direkë e me vela dhe me një ekuipazh që i përkiste raguzanëve, të cilin e angazhoi gjithashtu në punë me anijen e vet, Stiepan Pribiloviq de Malfo.<sup>132</sup> Ky i fundit ndër të tjera (siç do ta shohim këtë emër edhe më poshtë në lidhje me tregtinë e verës) me porosi të Radoes së lartpërmendur zotohej se do të shkonte në portin e Ishmit për të ngarkuar dru e më pas t'i sillte ato në *Molendinis Brenni* ose në Raguzë. Stefani duhej të merrte si shpërblim 25 perperë kur të kthehej dhe të paguante taksën e arborazhit, ndërsa atë të qëndrimit nëpër porte duhej ta shlyente në Arbëri.<sup>133</sup>

## Tregtia e vajit

Ulliri ka qenë në Arbëri një kulturë shumë e përhapur, ngaqë edhe kushtet klimaterike ishin shumë të përshtatshme për kultivimin e kësaj bime. Qytete të tëra me krahinat e tyre përreth, si Tivari, Ulqini, Shkodra Drishti, Durrësi, Berati, Vlora etj., përmenden në lidhje me kultivimin e

<sup>130</sup> *Archivio di Stato di Venezia* (më tej: ASV), Lett. e Comm. di Lev. IV, fol. 151-153, në *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV...*, vëll. II/1, dok. nr. 331.

<sup>131</sup> I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 351.

<sup>132</sup> DAD, Div. Notariae, vol. XLVI, fol. 127v., në Gjon Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut*, Dokumente, Hulumtoi dhe përgatiti Gjon Berisha, Instituti i Historisë "Ali Hadri", Prishtinë: 2018, nr. CLXXXI, f. 294.

<sup>133</sup> DAD, Div. Notariae, vol. XLVI, fol. 127v., në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti ...*, nr. CLXXXI, f. 294-296.

tij.<sup>134</sup> Një pjesë e prodhimit të vajit të ullirit përdorej për nevojat e popullsisë, kurse pjesa tjetër që ishte e konsiderueshme shitej nga tregtarët në vente të tjera bile edhe përtej detit. Për sa i përket prodhimit të vajit të ullirit dhe importimit të tij në Raguzë i rëndësishëm ishte Tivari, ngaqë aty kishte një traditë të vjetër në këtë kulturë, si rrjedhim ky qytet u bë një ndër qendrat më të rëndësishme të prodhimit të këtij produkti.<sup>135</sup> Pikë tjetër e rëndësishme ishte edhe qyteti i Ulqinit pak më në jug dhe që të dy këto qytete ishin stacione të rëndësishme jo vetëm të prodhimit,<sup>136</sup> por edhe të tregtisë që Raguzë bënte me qytetet veriore shqiptare, sepse prej aty rruga vazhdonte më tej nëpër Bunë për në Shën Shirq e pastaj deri në Shkodër. Njëri ndër tregtarët që merreshin me tregtinë e vajit të ullirit, ishte Matheus de Georgio, për të cilën folëm edhe më lart dhe që në vitet '90 të shek.XIV solli sasi të mëdha vaji nga Tivari për në Dubrovnik.<sup>137</sup>

Përveç qyteteve të lartpërmendura, për prodhimin e vajit ishin të rëndësishëm edhe Drishti e Kanina.<sup>138</sup> Për Drishtin, prodhimi i vajit të ullirit kishte një rëndësi jashtëzakonisht të veçantë pasi ky qytet duke u shtrirë në një vend malor i mungonte toka e përshtatshme për prodhimin e drithërave. Gjithë ekonominë e kishte të orientuar nga shitja e vajit dhe e verës, produkte të cilat i shiste në Raguzë, në Gadishullin Apenin dhe në vende të tjera. Ngaqë prodhimi duhet të ketë qenë i konsiderueshëm, kishin përfitime edhe vetë sunduesit e Drishtit në periudha të ndryshme.<sup>139</sup> Për shembull, bashkësia e Drishtit që në vitin 1396 qe e detyruar t'i paguante si taksë Republikës, një të dhjetën e prodhimit të verës, të vajit dhe të drithit, për çdo vit.<sup>140</sup>

<sup>134</sup> Spiro Shkurti, *Bujqësia në Arbërinë e shek. XIII-XVII*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë: 2002, f. 204.

<sup>135</sup> I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 352.

<sup>136</sup> S. Shkurti, *Bujqësia në Arbërinë e shek. XIII-XVII ...*, f. 204.

<sup>137</sup> I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 363.

<sup>138</sup> S. Shkurti, *Bujqësia në Arbërinë e shek. XIII-XVII ...*, f. 204.

<sup>139</sup> Në lidhje me tregtinë dhe prodhimet e Drishtit gjatë Mesjetës, shih më gjerë monografinë me titull: Edmond Malaj, *Drishti. Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetarë shqiptar*, QSA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2016, f. 211-221.

<sup>140</sup> *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*. Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Parstis Primae: Saeculum XIV complectentis. Tomus Tertius: Ab anno MCCCXCVI ad annum MCDVI. Centro internazionale di Studi Albanesi Palermo/ Istituto Universitario Orientale Napoli/ Istituto di Studi Albanesi del' Università di Roma/ Fondazione Giorgio Cini Venezia/ Ponteficio Istituto di Studi Orientali Roma/ Albanien Institut, Universität München/ Südost



Ashtu si në tregje dhe në qytete të tjera në Arbëri edhe në Drishtë importi dhe eksporti i vajit ishte i rregulluar me doganë, sipas disa zakoneve të vjetra. Kështu, tregtarët që vinin për të blerë vaj në Drishtë duhej të paguanin në doganën e këtij qyteti 12 groshë për barrë. Megjithatë, me urdhër të rektorit Nicolaus Treuisano, ky çmim i doganës së vajit u rrit dhe u bë 18 grosh për barrë vetëm në doganën e Drishtit, gjë që çoi në përkeqësimin e të ardhurave që vinin nga eksporti i këtij produkti shumë të rëndësishëm për Drishtin dhe krahinat e tij, sepse krahas 18 groshëve që duhej të paguheshin në doganën e Drishtit, e njëjta shumë duhej të paguhej edhe në dogana të tjera si në atë të Dejës apo të Shkodrës.<sup>141</sup>

Për të rregulluar këtë çështje, drishtjanët dërguan në Venedik si përfaqësues të tyre priftin Andreas. Kështu, Senati Venedikas mori vendimin që barra e vajit e dalë nga Drishtë të paguhej me 12 groshë në doganën e Drishtit dhe 6 groshë në doganën e Denjës.<sup>142</sup> Senati lejoi gjithashtu, që në doganë, në vend të parave, vaji të shkëmbehej me drithë, duke e importuar (por jo duke e eksportuar), ngaqë për shkak të luftërave që kishin ndodhur drithi ishte me mungesë të madhe.<sup>143</sup>

## Tregtia e verës

Vera gjithashtu ishte ndër mallrat kryesore që tregtohej ndërmjet Raguzës dhe Arbërisë. Tregtia dhe transporti bëhej në dy drejtimet. Pra, në Arbëri vera importohej nga Ragusa apo nga tregtarët raguzanë, por në këtë qytet shkonte edhe vera arbërore. Njëra ndër verërat që ishte e njohur në atë kohë, është vera nga rrushi i bardhë *Malvasia*, e cila në Mesjetë ishte e trashë dhe e fortë, por që sot përfshihet në verërat e buta dhe prodhohet kryesisht në Dalmaci.<sup>144</sup> Ajo prodhohej edhe në trojet arbërore e në vende të tjera të Ballkanit dhe të Evropës, por si origjinë ishte nga

---

Institut, München / Institut für Geschichte und Kultur des Nahen Orients, sowie für Turkologie, Universität München. München: Rudolph Trofenik 1968, dok. nr. 667 (cituar më tej: AAV, III); shih edhe: AAlb. II, dok. nr. 573.

<sup>141</sup> *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV*, vëll. I (1400-1405), përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1987, dok. nr. 333.

<sup>142</sup> AAlb. II, dok. nr. 728; AAV, III, dok. nr. 1034.

<sup>143</sup> AAlb. II, dok. nr. 728; AAV, III, dok. nr. 1034.

<sup>144</sup> J. Howell, *The Ragusa Road...*, f. 68.

Malvazia e Napolit. Një verë tjetër, e cila ishte më e butë dhe shërbente si verë deserti quhej *Romania* me origjinë nga Peloponezi Lindor. Medievisti i shquar, Milan Shuflaj i përmend të dyja këto verëra në romanin e tij “Kostandin Balsha”.<sup>145</sup> Pra, përveçse vinte verë nga Raguzia dhe nga vende të tjera, edhe nga Arbëria dilte dhe shkonte nëpër tregjet e huaja një sasi e madhe vere, sepse kultivimi i hardhisë dhe nxjerrja e verës ishte një ndër degët më të rëndësishme në Arbëri, e cila ishte e mbushur nga veriu në jug me vreshta të shumta, nga të cilat prodhoheshin me mijëra barrë verë.<sup>146</sup> Njësia matëse “barrë”, ndryshonte nga tregu në treg dhe nga vendi në vend. Më poshtë po e ilustruam këto aktivitet edhe me disa emra personash dhe me fakte e shifra, të nxjerra nga dokumentet e kohës.

Më 31 mars 1407, në Dubrovnik bëhet një kontratë për të sjellë një barkë me verë në Tivar.<sup>147</sup> Kurse në qershor të vitit 1408 tregtari Boksa Ratkoviç urdhërohet që, brenda tetë ditëve duhet të shkonte në *Tivar* për t’u marrë vesh në lidhje me çështjen e doganës së verës, që nuk kishte paguar.<sup>148</sup> Në vitin 1430 kemi të dokumentuar një eksport vere nga Gjon Kastrioti për në Raguzë.<sup>149</sup>

Në një dokument të datës 9 dhjetor të vitit 1462 përmendet një varkëtar raguzan i quajtur Radoe Miloseviç (Radoe Milosseuich), i cili pasi kishte marrë me qira një anije me direktë e me vela dhe me një ekuipazh që i përkiste raguzanëve e angazhoi në punë me anijen e vet, Stiepan Pribiloviç de Malfo.<sup>150</sup> Stiepani zotohej se do të shkonte në Tersteniç të Kosovës për të marrë verë dhe më pas në Durrës ku do të

<sup>145</sup> Milan Shuflaj (Alba Limi), *Kostandin Balsha*, përktheu Xhelal Fejza, MHK, Tiranë: 2005, f. 45.

<sup>146</sup> Për të dhëna në lidhje me kultivimin e hardhive dhe tregtinë e verës, shih më gjerë te: S. Shkurti, *Bujqësia në Arbërinë e shek. XIII-XVII*. ..., f. 125-169. Rëndësi të veçanë në lidhje me të ardhurat nga vreshtat ka pasqyra në: *po aty*, f. 165-166.

<sup>147</sup> DAD, Reform, Vol. XXXIII, fol. 15, në *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV*..., vëll. II/1, dok. nr. 121.

<sup>148</sup> DAD, Reform. Vol. XXXIII, fol. 59 (53): “*die xxj. Junij [1408] contra bogxa. In Minorj Consilio captum fuit de precipiendo Bochxe Ratchouich quod Infra octo dies proximas ire debeat Antibarum. ad concordandum super facto duhane vinj pro ut melius sui erit.*”, në *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV*..., vëll. II/1, dok. nr. 252.

<sup>149</sup> Dhimitër Shuteriqi, *Moti i madh*, Përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479, Tiranë: Dituria 2006, f. 73.

<sup>150</sup> DAD, Div. Notariae, vol. XLVI, fol. 127v. në Gjon Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut*..., nr. CLXXXI, f. 294.

qëndronte për gjashtëmbëdhjetë ditë me qëllim që të shiste verën e lartpërmendur. Pas kësaj pune ai duhet të shkonte në portin e Ishmit për të ngarkuar dru e më pas t'i sillte ato në Molendinis Brenni ose në Raguzë.<sup>151</sup> Rastet janë të shumta dhe kanë të bëjnë me tregje e lokalitete arbërore të ndryshme dhe me tregtarë të shumtë, por në këtë artikull po mjaftohemi vetëm me kaq.

### **Tregtia e saragave dhe e produkteve të tjera të liqeneve**

Një artikull i rëndësishëm ishte edhe saraga apo gjuca e thatë (*sarrucha, sarracha*), e cila prodhohej kryesisht në krahinat përreth liqenit të Shkodrës dhe importohej në shumë vende që kishin marrëdhënie tregtie me Shkodrën. Këto saraga të thata importoheshin edhe në Raguzë ku transporti i tyre vazhdoi deri vonë ndërmjet Shkodrës dhe Dubrovnikut, që nga mesjeta deri në shek. XX, pra, edhe atëherë kur Republika e Raguzës nuk ekzistonte më si shtet. Tregtarët raguzanë vinin e i merrnin këto prodhime në portin e Shën Shirqit, në Shkodër etj. Importimi i tyre në Raguzë ishte i rregulluar me ligj nga Këshilli i Rogatëve, dhe tejkalimi i tyre ishte i dënueshëm. Si shembull mund të përmendet këtu rasti, ku dy tregtarë raguzanë akuzojnë konsullin Georgium de Cruze, i cili në portin e Shën Shirqit kishte ngarkuar dy barka me saraga dhe i kishte dërguar ato për në Pulje, duke vepruar kështu në kundërshtim me rregullat e vendosura nga Këshilli i Rogatëve<sup>152</sup>, që mesa duket parashikonte që saragat (si produkt ushqimor) duhej të dërgoheshin në Raguzë.

### **Tregtia e cohërave, tekstileve dhe bizhuterive**

Nga Arbëria vinin edhe objekte të ndryshme, si për shembull veshje, rripa vathë, apo gjëra të tjera, të cilat po i rendisim në të ashtuquajturat objekte kulturore, siç i specifikon edhe studiuesja Verena Han.<sup>153</sup> Këto

<sup>151</sup> DAD, Div. Notariae, vol. XLVI, fol. 127v. në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut...*, nr. CLXXXI, f. 294-296.

<sup>152</sup> *AAlb.* I, dok. nr. 539.

<sup>153</sup> Verena Han, "La culture matérielle des Balkans au Moyen Age à travers la documentation des Archives de Dubrovnik", në *Balkanica. Annuaire de l'Institute des*

produkte, të cilat hasen kryesisht në shekujt XIV dhe XV mbanin emrin e origjinës në formën e atributit *albanus* (!), *albanescus*, (*arbëror*) ose shënohen me emrat e qendrave shqiptare, ku prodhoheshin si *ad Avlonam, de Avlona, de Duraço* etj.<sup>154</sup> Duke u bazuar tek dokumentet mund të thuhet se gjatë dhjetë viteve të fundit të shek. XIV dhe fillimit të shek. XV në Arbëri pati një zhvillim prodhimi i pëlhurave.

Pëlhurat shqiptare mbërritën edhe në Republikën e Raguzës. Në fund të shek. XIV, përmendet në Raguzë *zambelotto*, që ishte një pëlhurë e bërë nga leshi deve (*unam peciam zambilloti virmilei, laboratum ad Avalonam, 1389*)<sup>155</sup>. Përveç kësaj përmendet edhe pëlhura shqiptare e njohur përgjithësisht si (*unam peciam pani albani, 1402*).<sup>156</sup> Meqenëse pëlhurat shqiptare përmenden si në posedim të rrobaqepësve të Dubrovnikut mund të supozojmë se banorët e këtij qyteti i kishin prerë rrobat tek këta rrobaqepës. Përsa i përket pëlhurave dhe cohërave, ato gjithashtu shkonin edhe nga Ragusa në Arbëri dhe prej aty kalonin nëpër rrugë tregtare drejt tregjeve të Skllavonisë.<sup>157</sup> Pra, tregtia e këtyre mallrave ishte e dyanshme.

Nëpër dokumentet e arkivave të Dubrovnikut përmenden edhe lloje rrobash që vishnin shqiptarët. Për shembull në shek. XV përmenden dy lloje xhaketash që përdorshin në Arbëri, njëra ishte *pavonasa* (*pavonaça*) dhe tjetra, duke u nisur nga emri, mbase ishte nga mëndafshi dhe me ngjyrë të gjelbër (*alia est sete viride*)<sup>158</sup>. Dokumentet arkivore përmendin edhe kapelat shqiptare (*capelli albanenses*), të cilat u sollën në Raguzë në shek. XV, por në lidhje me pamjen e tyre nuk jepen të dhëna.<sup>159</sup>

---

*Etudes Balkaniques*, III, Académie Serbe des Sciences et Arts (Institute des Etudes Balkaniques) Beograd: 1972, f. 179.

<sup>154</sup> Po aty.

<sup>155</sup> DAD, Div. Canc. Vol. 29, fol. 80, në V. Han, "La culture matérielle des Balkans ...", f. 179.

<sup>156</sup> DAD, Distributions test. Vol. 6, fol. 128, në V. Han, "La culture matérielle des Balkans ...", f. 179.

<sup>157</sup> ASV, Lett. E Comm. di Lev. IV, fo. 151-153, në *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV...*, vëll. II/1, dok. nr. 331.

<sup>158</sup> DAD, Div. Canc. Vol. 58, fol. 197: "*et duos vestes ad usum Albanie quorum una est pavonaça et alia est sete viride, 1444*", në V. Han, "La culture matérielle des Balkans ...", f. 179.

<sup>159</sup> DAD, Div. Canc. Vol. XI, fol. 27 v, në V. Han, "La culture matérielle des Balkans ...", f. 179.

Artikuj të tjerë që prodhoheshin në Arbërinë mesjetare dhe eksportoheshin për në Raguzë ishin edhe rripat. Mesa duket Durrësi ishte i njohur për këto lloje produktesh. Në vitin 1355, një anije që transportonte mallra për në Dubrovnik, sulmohet dhe grabitet nga piratët në ujërat dalmatë. Në listën e objekteve të plaçkitura në këtë anije përmenden edhe rripat (*centuras VI de Duraço valoris yperperi I*), të cilat duke pasur parasysh çmimin tepër modest, pra gjashtë copë (*centuras VI*) me një vlerë prej 1 perper (*yperperi I*) ishin mesa duket prej tekstili ose lëkure, dhe jo të një cilësie shumë të lartë.<sup>160</sup> Produkte të tjera që eksportoheshin qenë edhe bizhuteritë. Prej këtyre përmenden sidomos vathët e mëdhenj që ishin prodhuar në Vlorë (*i par de cercelli grandi de Avalona*, 1387),<sup>161</sup> materiali përbërës i të cilëve nuk përmendet.

Përsa u përket këtyre prodhimeve artizanale, përveç tregtisë me Raguzën në trojet arbërore hasim artizanë<sup>162</sup> dhe mjeshtër raguzanë që operonin në qytete të ndryshme. Si shembull mund të përmendim këtu argjendarë të ndryshëm, gjithsej 27 vetë për periudhën 1408-1415, 5 rrobaqepës (1407-1435), 9 gëzoftarë (1424-1447) që vepronin kryesisht në Novo Bërdë të Kosovës.<sup>163</sup>

## Përfundime

Siç u pa edhe më lart tregtia ndërmjet Republikës së Raguzës dhe trojeve arbërore ishte mjaft e gjerë dhe aktive. Në të ishin të përfshira shumica e tregjeve arbërore dhe pothuajse çdo qytet që kishte peshë në tregti, kishte edhe një komunitet tregtarësh raguzanë, të cilët përfaqësoheshin nga konsulli i tyre. Përveç konsujve dhe tregtarëve që ishin të pranishëm nëpër qytetet dhe tregjet e trojeve arbërore, raguzanët kishin arritur që të shtinin në dorë dogana të produkteve të ndryshme, të cilat i merrnin me qira dhe u paguanin sundimtarëve vendas detyrimet në lidhje me to. Tregtia me Raguzën kishte rëndësi të madhe pasi, në Arbri vinin mallra nga viset perëndimore evropiane dhe nga vende të tjera. Nga

<sup>160</sup> V. Han, "La culture matérielle des Balkans ...", f. 179, f. 179-180.

<sup>161</sup> Po aty.

<sup>162</sup> Mbi artizanët dhe mjeshtër arbërorë dhe aktivitetin e tyre në Raguzë kemi folur tashmë në artikullin tonë të botuar me titull: Edmond Malaj, "Mjeshtërit dhe zejtarët shqiptarë në Raguzë gjatë Mesjetës", në *Studime historike*, nr. 1-2, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2020, f. 7-36.

<sup>163</sup> M. Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore ...*, f. 126.

ana tjetër, mallrat dhe prodhimet arbërore arrinin dhe bëheshin të njohura jo vetëm në Raguzë, por edhe më tej nëpër Evropë. Përveç kësaj, marrëdhëniet tregtare me Raguzën kishin edhe një impakt në kulturën dhe mjeshtërinë e vendit, e cila përfitonte nga teknikat që shkëmbeheshin nëpërmjet tregtisë. Kjo mund të shihet për shembull në përpunimin e arit e të argjendit, në rrobaqepës dhe në zeje të tjera.<sup>164</sup> Si përfundim, mund të themi, që marrëdhëniet tregtare me Raguzën ishin të një rëndësie të jashtëzakonshme për Arbërinë të cilat zinin një vend kryesor në marrëdhëniet ekonomike që trojet arbërore kishin me vendet e huaja gjatë Mesjetës.

### *S u m m a r y*

#### ECONOMIC AND TRADE RELATIONS BETWEEN RAGUSA AND ALBANIAN LANDS DURING THE MIDDLE AGES

Trade between the Republic of Ragusa and the Medieval Albanian lands was quite extensive and active and included most of the Albanian markets. Almost in every town with importance in trade, there was a community of Ragusan merchants. Their consuls represented those communities. Besides the consuls and merchants who were present in the cities and markets of Albania, the Ragusans had seized the customs of various products, which they rented and paid to the local rulers for the duties related to them. The Trade with Ragusa was of great importance because in Albania came wares from Western European areas and other countries. Reciprocally, Albanian products arrived not only in Ragusa. Albanian Merchants exported further their wares through Europe. In addition, trade relations with Ragusa affected the culture and mastery of the country, too, which benefited from techniques exchanged through trade. That was seen in the elaborating of gold and silver, tailoring, and other crafts. In conclusion, we can say that trade relations with Ragusa were of great importance to Albania. These relations were a key in the economic exchanges the Albanians had with other foreign countries during the Middle Ages.

---

<sup>164</sup> Për më gjerë në lidhje me këto marrëdhënie në zejtari e në profesione të ndryshme shih gjithashtu artikullin tonë të sipërcituar: E. Malaj, “Mjeshtërit dhe zejtarët shqiptarë...”, f. 7-36.